

URDHËR
Nr. 675, datë 25.6.2026

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË APLIKIMEVE NË SKEMËN KOMBËTARE TË
MBËSHTETJES PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; të shkronjës “c”, pika 2, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”; të VKM-së nr. 205, datë 30.3.2026, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2026”; si dhe të pikës “b”, të kreut IV, të udhëzimit nr. 8, datë 14.5.2026, “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për masat mbështetëse për vitin 2026”,

URDHËROJ:

1. Zgjatjen e afatit të aplikimeve, për të gjitha masat mbështetëse të përcaktuara në udhëzimin nr. 8, datë 14.5.2026, “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për masat mbështetëse për vitin 2026”, deri më datë 6.7.2026, ora 16:30.

2. Ngarkohet Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**
Andis Salla